



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 3088 Prot

Vlorë, më 27.02 2024

Lënda : Mbi miratimin e planit të pranimit/rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2024.

Në zbatim të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neni 18, "Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil", Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil" dhe VKB nr. 92, datë 23.11.2023 "Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara - 2024". miratohet plani i pranimit/rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2024 si më poshtë;

Bazuar në gjurmën a) "*Mbushjen e moshës së pensionit të nëpunësit civil*" të pikës 3, të VKM nr. 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", në stafin e Bashkisë Vlorë, për vitin kalendarik Janar-Dhjetor 2024, janë **3 punonjës** të cilët kanë mbushur moshën e pensionit **(3 pozicione)**.

Bazuar në gjurmën b) "*Parashikimin e vendeve të reja në shërbimin civil*", të pikës 3, të VKM nr. 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", pozicionet vakante të planifikuara për vitin kalendarik Janar-Dhjetor 2024, janë **26 pozicione**.

Gjithsej vende vakante në shërbimin civil për periudhën Janar - Dhjetor 2024 në Bashkinë Vlorë janë **29 pozicione**.

**PLANI VJETOR I PRANIMEVE NË SHËRBIMIN CIVIL TË BASHKISË VLORE PËR
VITIN 2024**

Vende të lira në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil	Kategoria	Numri i Vendeve Vakante	Klasa	Lloji i procedurës
Drejtor i Përgjithshëm	Nivel i lartë	3	II/a	Lëvizje paralele/Ngritje në detyrë
Drejtor drejtorie	Nivel i mesëm drejtues	3	II/b	Lëvizje paralele/Ngritje në detyrë
Përgjegjës sektori	Nivel i ulët drejtues	6	III/a	Lëvizje paralele/Ngritje në detyrë
Specialist	Nivel Ekzekutiv	14	III/b IV/a IV/b	Lëvizje paralele/Pranim në shërbim civil

KRYETAR

Ermal Dredha

